**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE**
**KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË**

**Nr.** 129 **Prot** **Tiranë, më** 29.08**, 2011**

**VENDIM Nr. 169, dt. 29.08.2011**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" **(i ndryshuar),** Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 29.08.2011, mbasi shqyrtoi propozimin e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik për kryerjen e survejit arkeologjik të Projektit Hidroenergjetik në Lumin Devoll (**Subjekti "Devoll Hydropower" Sh.A.**), nga subjekte privatë të liçencuar nën mbikëqyrjen e ASHA,

**VENDOSI:**

**I.** Të shtyjë shqyrtimin për kryerjen e sërvejit arkeologjik për Projektin Hidroenergjetik në Lumin Devoll deri në përgatitjen e një relacioni përmbledhës mbi procedurat administrative dhe ligjore të përzgjedhjes së subjekteve privatë të liçencuar dhe praktikës së ndjekur në vendet e BE në raste të ngjashme për kryerjen e sërvejit arkeologjik përpara fillimit të zbatimit të projekteve të mëdha të infrastrukturës.

**II.** Pas miratimit të procedurave, projekti i mësipërm do të shqyrtohet nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë për marrjen e një vendimi përfundimtar.

**III.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**
**ALDO BUMÇI**
**MINISTËR**

**SEKRETAR I KKA**
**ROLAND OLLI**

REPUBLIKA E SHQIPERISË MINISTRIA E TURIZMIT KULTURËS RINISË DHE SPORTEVE AGJENCIA E SHËRBIMIT ARKEOLOGJIK TIRANË

AGJENCIA E SHERBIMIT ARKEOLOGJIK
Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171
e-mail: sekretaria.teknike@asha.gov.al